

NGJITËSIT E PLLAKAVE



ECO+ C2E

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
E bardhë, Gri	25 KG	3-5 KG

PËRSHKRIM

Ngjitës për pllaka me bazë çimentoje (C), me forcë ngjitëse të përmisuar dhe kohë punueshmërie të gjatë (E), i përbërë nga rëra karbonatesh të cilësisë së lartë dhe aditivë specifik. I klasifikuar si ngjitës C2E sipas standartit EN 12004. Karakterizohet nga një punueshmëri e shkëlqyer, rezistencë shumë e mirë ndaj lagështisë dhe ndaj ngricave. Aplikohet për shtresa deri në trashësi 6 mm.

FUSHA E APLIKIMIT

I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave të qeramikes në suporte me bazë çimento, gres-porcelanit, klinkerit, mermerit të pllakave me absorbim të ulët. Për ngjitjen në bazamente me një lëvizshmëri të caktuar të tilla si ballkone, banjo, për dysheme dhe mure në ambiente të jashtme dhe të brendshme ku ka prani lagështie. Për dysheme me trafik të lartë si shkolla dhe spitale. Për ambiente tregtare dhe industriale. I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave për formate mesatare dhe të mëdhaja (5 – 80 cm).

MËNYRA E PËRGATITJES SË PËRZIERJES

Përzieri 6.5-7 litra ujë të pastër me 25 kg Eco+, përzieri masën e krijuar me një përzierës elektrik derisa të formohet një masë homogjene dhe pa kokrriza. Lëreni në qetësi për 10 minuta dhe më pas përzieri përsëri përpara përdorimit. Koha e punueshmërisë së përzierjes është 2-3 orë. Në kushte normale temperaturash (20°C).

PËRGATITJA E SUPORTIT

Suportet me bazë çimento duhet të jenë të qëndrueshëm, rezistent dhe të rregullt, pa vajra dhe jo të pista dhe pa mbetje bojrash si dhe duhet të kenë arritur paraprakisht kohën e maturimit. Përafërsisht dyshemet tradicionale me bazë çimento me kohë fortësimi normale duhet të kenë një kohë stazhionimi të paktën 28 ditë, bazamentet me suva tradicionale duhet të thahen për të paktën 14 ditë. Disnivelet e mëdha ose çarjet e mëdha duhen të rregullohen paraprakisht. Të gjitha tipet e suporteve duhet të pastrohen paraprakisht para aplikimit të produktit në mënyrë mekanike. Përpara aplikimit të produktit, sipërfaqja e suportit duhet të spërkatet me ujë në mënyrë që produkti të krijojë një ngjitje sa më të mirë dhe të ketë një kohë punueshmërie sa më optimale.





APLIKIMI

Fillimisht produkti rekomandohet të shtrohet me pjesën e drejtë të mallës për të pasur një shpërndarje sa më të njëtrajtshme dhe më pas me pjesën e dhëmbëzuar. Aplikimi bëhet me një mallë të përshtatshme në varësi të llojit të pllakës që shtrohet. Vendosja e pllakave bëhet duke ushtruar një presion të vogël mbi pllakë duke u siguruar që pllaka të mbulohet në të gjithë sipërfaqjen me kollë. Koha e hapjes së produktit në kushte atmosferike normale është 35 minuta për temperatura 23°C. Kushtet atmosferike mund të ndikojnë në kohën e tharjes së produktit. Duhet pasur kujdes që kolla nuk duhet të formojë sipërfaqje filmi. Në të kundërt atëherë është e nevojshme që të kalohet dhe një herë malla mbi kollë. Në sipërfaqjet e bashkimit me muret vertikale duhet lënë një distancë prej 5 mm.

TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	Koha e korigjimit: 30 min
Paketimi: Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg	Mbushja e fugave në mure: Pas 8 deri 12 orësh
Ngjyra: E Bardhë, Gri	Mbushja e fugave në dyshe: Pas 24 orësh
Konsumi: 3-5 kg/m ²	I shkëlshëm: Pas 24 orësh
Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri	Forca ngjitetë pas 28 ditësh: $\geq 1 \text{ N/mm}^2$
Koha e Magazinit: 12 muaj nga data e prodhimit	FN pas zhytjes në ujë: $\geq 1 \text{ N/mm}^2$
Masa Vëllimore: 1.5-1.6 gr/cm ³	FN pas reaksionit nga ngrohja: $\geq 1 \text{ N/mm}^2$
Reaksioni ndaj zjarrit: Klasa A1	FN pas cikleve ngrirje-shkrirje: $\geq 1 \text{ N/mm}^2$
Ujë për përzierje: 6 litra ujë për 25 kg	FN pas 30 min: $\geq 0,5 \text{ N/mm}^2$
pH i përzierjes: 13	Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C



KUJDESI! Si temperaturat e ulta dhe temperaturat e larta mund të ndryshojnë karakteristikat e punimit të produktit (ngadalsim ose përspejtim në tharje të produktit). Mos e përdorni në:

- Suporte druri, metali, PVC apo sipërfaqe të tjera jo me bazë çimento.
- Për pllaka me dimensione të mëdha dhe të rënda.
- Për ambiente me ngrohje qëndrore, në ambiente ku ka lagështirë të vazhdueshme, suporte që karakterizohen nga vibrime të paqëndrueshme.
- Në temperatura të larta, të ulëta, me erë të fortë.